

Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit



LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

MUAJI SHKURT 2026

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për lirimin nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.	NRP-02-6963-2026
2.	Vendim për emërimin e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.	NRP-02-6964-2026
3.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare.	NRP-02-6969-2026
4.	Vendim për caktimin e këshillit oragnizues për Festën e "Pavarsisë së Kosovës"	NRP-02-6970-2026
5.	Vendim për vendimin për lejimin e qasjes ne SIMFK.	NRP-02-6976-2026
6.	Vendim për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës së Rahovecit.	NRP-02-6978-2026
7.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-6982-2026
8.	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e planit për trashëgimi kulturore në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-6985-2026
9.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-6990-2026
10.	Vendim për vlerësimin e dëmeve në palestrën "Mizair Isma" në Rahovec.	NRP-02-6991-2026
11.	Vendim për qasje në dokumente publike.	NRP-02-6992-2026
12.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-6995-2026
13.	Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë.	NRP-02-6996-2026
14.	Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një vjet të pronës së paluajtshme të komunës.	NRP-02-6997-2026
15.	Vendim për mbulimin e shpenzimeve financiare.	NRP-02-6999-2026
16.	Vendim për miratimin e kërkesës mbështetje nga masat emergjente të riintegritit.	NRP-02-7002-2026
17.	Vendim për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një vjet të pronës së paluajtshme të komunës.	NRP-02-7003-2026
18.	Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë.	NRP-02-7005-2026
19.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e aseteve kapitale dhe jokapitale jashtë përdorimit	NRP-02-7009-2026
20.	Vendim për caktimin e komisionit për asgjësimine pasurisë kapitale dhe jokapitale	NRP-02-7010-2026

21.	Vendim për caktimin e grupit përfaqësues për zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3	NRP-02-7013-2026
22.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike.	NRP-02-7016-2026
23.	Vendim për dhënien e pushimit të Lehonisë	NRP-02-7020-2026
24.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.	NRP-02-7023-2026
25.	Vendim për caktimin e këshillit oragnizues të festivalit traditcional folklorik "Anadrinia Jehon" 2026.	NRP-02-7030-2026
26.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-7035-2026
27.	Vendim për miratimin e kërkesës për strehim të përkohëshëm emeregjent.	NRP-02-7036-2026
28.	Vendim për caktimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-7041-2026

Shkurt, 2026

Rahovec



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6963 Nr. i faq./Br.str./No.pg 109
Data/Datum/Date 30 / 01 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 shkronja f) dhe nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-28/2008") dhe nenit 81 paragrafi 1.1 dhe nenit 84 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës së Erhan Morina nga fshati Xërxë me Nr. Prot. 01-151/02-0004400/26 e datës 30.01.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

1. Z. Erhan Morina **LIROHET** nga pozita e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit nga data 30.01.2026.
2. Autorizohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të lartpërmendurin në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Erhan Morina,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
- **NJMBNJ, dhe**
- **Arkivi.**

Smail Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6964 Nr. i faq./Br.str./No.pg 199

Data/Datum/Date 30 / 01 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenin 58 dhe nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.12, nenit 81 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 84 paragrafi 2, 3 dhe 4, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 26 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092, të datës 27.3.2015, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

1. Behar Thaqi nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, **EMËROHET** drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit.
2. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës 29.3.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092, të datës 27.3.2015 dhe nga kryetari i Komunës.
3. Ky emërim fillon nga data **1.2.2026** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të emëruarit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Zyrës së personelit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 069 Nr. i faq./Br.str./No.pg 199
Data/Datum/Date 03 / 02 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 16 paragrafi 1 pika 1.11 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017 dhe kërkesës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm të datës 20.1.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për mbulimin e shpenzimeve financiare

1. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm e datës 20.1.2026, për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të akomodimit të 5 (pesë) bizneseve të komunës së Rahovecit në panairin ndërkombëtar të tekstit në Stamboll, si në vijim:
 - 1.1. N.T. "EM TEX" me nr. unit identifikues [REDACTED], me përfaqësues Blendi Kërquagu;
 - 1.2. "GD RAMA" Sh.P.K. me nr. unit identifikues [REDACTED], me përfaqësues Shukri Rama;
 - 1.3. "FARAS GR" Sh.P.K. me nr. unit identifikues [REDACTED], me përfaqësues Ramadan Haxhimeri;
 - 1.4. "AGIM HOXHA" B.I. me nr. unit identifikues [REDACTED], me përfaqësues Agim Hoxha;
 - 1.5. D.P.Z. "KOMOD – D" me nr. unit identifikues [REDACTED], me përfaqësues Ylber Korenica.
2. Të lartpërmendurit do të marrin pjesë në panairin ndërkombëtar të tekstit, i cili do të mbahet në Stamboll të Turqisë nga data 4.2.2026 deri më datë 7.2.2026.
3. Shuma e mjeteve të pjesëmarrjes të bizneseve të cekur në nenin 1 të këtij vendimi është 202.00€ (dyqind e dy euro) për person, në shumën totale prej 1,010.00€ (një mijë e dhjetë euro), të cilat do të sigurohen nga kodë i subvencioneve të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, më datë 20.1.2026, ka parashtruar kërkesë për mbështetje financiare të 5 (pesë) bizneseve të komunës së Rahovecit, për të marrë pjesë në panairin ndërkombëtar të tekstilit, i cili do të mbahet në Stamboll të Turqisë, nga data 4.2.2026 deri më datë 7.2.2026.

Pas konsultimit me Shoqatën e Afaristëve në Rahovec, bizneset e cekura në dispozitiv të këtij vendimi, do të marrin pjesë në këtë panair, me qëllim të avancimit dhe të shkëmbimit të përvojave dhe të materialeve të fundit në tregun ndërkombëtar.

Duke marrë parasysh këtë, Komuna e Rahovecit do të bëjë mbështetjen financiare të pjesëmarrjes së këtyre bizneseve në panair, duke i mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit, në shumën prej 202.00€ (dyqind e dy euro) për person, në shumën totale prej 1,010.00€ (një mijë e dhjetë euro) për bizneset e cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Përfaqësuesit e bizneseve,*
- *Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6370 Nr. i faq/Br.str/No.pg 199

Data/Datum/Date 03/02/26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e këshillit organizues për Festën e "Pavarësisë së Kosovës"

1. Caktohet këshilli organizues për Festën e Pavarësisë së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Betim Zllanoga, kryesues,
 - 1.2. Fatmir Iska, anëtar,
 - 1.3. Atdhe Rama, anëtar,
 - 1.4. Altin Zhuniqi, anëtar,
 - 1.5. Afrim Oruqi, anëtar,
 - 1.6. Muhamet Morina, anëtar,
 - 1.7. Besmire Bytyqi, anëtare,
 - 1.8. Blerta Gashi, anëtare,
 - 1.9. Ardit Halilaj, anëtar,
 - 1.10. Shadat Ukaj, anëtar,
 - 1.11. Naser Dula, anëtar,
 - 1.12. Fehmi Hoxha, anëtar,
 - 1.13. Nadir Sylejmani, anëtar,
 - 1.14. Qemajl Keasniqi, anëtar,
 - 1.15. Feriz Thaqi, anëtar,
 - 1.16. Muharem Morina, anëtar,
 - 1.17. Almedina Jaha, anëtare.
2. Këshilli organizues për Festën e Pavarësisë së Kosovës, ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet organizative për mbarëvajtjen e festës së Pavarësisë së Kosovës.
3. Obligohet këshilli organizues që të hartojë raport të detajuar për Kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të Festës së Pavarësisë së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e këshillit organizues.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e këshillit organizues, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6976 Nr. i faq./Br.str./No.pg 200

Data/Datum/Date 06 / 02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008"), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008"), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-108, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e qasjes në SIMFK

1. Znj. Njomëza Fazliu, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, i **LEJOHET** qasja në SIMFK për Modulin e të Hyrave për vitin fiskal 2026.
2. I **NDALOHET** qasja në SIMFK z. Reshat Shehu për shkak të pensionimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, do të përkujdeset e lartpërmendura në pikën 1 të këtij vendimi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që z. Reshat Shehu, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar i të Hyrave në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, del në pension më datë 4.2.2026 dhe nuk mund të ketë qasje në sistemin SIMFK.

Për këtë arsye, znj. Njomëza Fazliu, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, i lejohet qasja në SIMFK për vitin fiskal për vitin 2026, pasi ka certifikatë për përfundimin e trajnimit të Modulit të të hyrave SIMFK nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Njomëza Fazliu,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Departamentit i Thesarit në MFPT, dhe
- Arkivi.


Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 11 paragrafi 3 pika 3.1, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Rahovecit

1. **Caktohet** grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Smajl Latifi – Kryetar i Komunës, kryesues;
 - 1.2. Betim Zillanoga – Nënkyetar i Komunës, koordinator me drejtorë të drejtorive;
 - 1.3. Afrim Dina – Drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar;
 - 1.4. Berat Duraku - Kuvendi i Komunës, anëtar;
 - 1.5. Lirigzon Kastrati – Kuvendi i Komunës, anëtar;
 - 1.6. Melinda Oruqi-Iska - Kuvendi i Komunës, anëtare;
 - 1.7. Defrim Kafexhiu - Kuvendi i Komunës, anëtar;
 - 1.8. Isak Hoti – Udhëheqës i Zyrës Ligjore, anëtar;
 - 1.9. Mirsad Shala – Zyrtar Ligjor, anëtar.
2. Grupi punues ka për detyrë që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Rahovecit, duke u bazuar në rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës, drejtoritë Komunale dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës.
3. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/4418, i datës 8.7.2024.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 6982 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01		
Data/Datum/Date 05.02.26		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe kërkesës së z. Isuf Hoti me nr. prot. 652, të datës 26.1.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e z. Isuf Hoti nga Polluzha, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: “Mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe” në ShFMU “Rilindja” në Çifllak, nga data 1.3.2026 deri më 31.8.2026.
2. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit, që ta largojë nga lista e pagës zyrtarin e lartpërmendur për periudhën e lartcekur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Isuf Hoti nga Polluzha, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: “Mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe” në ShFMU “Rilindja” në Çifllak, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 652, të datës 26.1.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje nga data 1.3.2026, deri më datë 31.8.2026.

Kërkesën, i lartpërmenduri, e ka parashtruar për arsye personale, respektivisht për arsye të avancimit profesional.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurit i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për

orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë për arsye personale.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Isuf Hoti,*
- *Drejtorja për Arsim,*
- *Drejtorja për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrtari/ja për paga,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6985 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Date 06 / 02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e planit për trashëgimi kulturore në Komunën e Rahovecit

1. **Caktohet** grupi punues për hartimin e planit për trashëgimi kulturore në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Atdhe Rama, kryesues,
 - 1.2. Altin Zhuniqi, anëtar,
 - 1.3. Afrim Dina, anëtar,
 - 1.4. Irfan Ramadani, anëtar,
 - 1.5. Qemajl Krasniqi, anëtar,
 - 1.6. Blerta Gashi, anëtare,
 - 1.7. Mirsad Shala, anëtar,
 - 1.8. Skender Hamza, anëtar,
 - 1.9. Fjolla Duraku, anëtare,
 - 1.10. Shadat Ukaj, anëtar,
 - 1.11. Saranda Shala, anëtare,
 - 1.12. Granita Behra, anëtare,
 - 1.13. Arsim Kastrati, anëtar.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë planin për trashëgimi kulturore në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6990 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 09 / 02 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023”), nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Alban Bajraktarit nga Polluzha, nr. prot. 793, të datës 9.2.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Alban Bajraktarit nga fshati Polluzhë, komuna e Rahovecit, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i gjuhës angleze në ShFMU “Rudolf Walther” në Dejnë, nga data 1.2.2026 deri më datë 31.1.2027.
2. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë të lartpërmendurin nga lista e pagës për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsy et im

Alban Bajraktari nga fshati Polluzhë, komuna e Rahovecit, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënës i gjuhës angleze në ShFMU “Rudolf Walther” në Dejnë, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 793, të datës 9.2.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 1.2.2026 deri më datë 31.1.2027.

Kërkesën për pushim nga puna pa pagesë, i lartpërmenduri, e ka parashtruar për shkak të ngritjes së kapaciteteve profesionale, të cilat do të jenë në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurit i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 6991 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 02
Data/Datum/Date 09.02.2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për vlerësimin e dëmeve në palestrën sportive “Mizair Isma” në Rahovec

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e dëmeve në palestrën sportive “Mizair Isma”, në këtë përbërje:
 - 1.1. Arsim Kastrati - DKRS, kryesues,
 - 1.2. Valon Hoti - inspektor, anëtar,
 - 1.3. Venhar Topalli - DShP, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga një grup personash gjatë lojës së basketbollit, më datë 8.2.2026.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të vlerësimit të dëmeve në palestrën sportive “Mizair Isma” në Rahovec, ta njoftojë Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Laifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 692 Nr. i faq./Br.str/No.pg 02

Data/Datum/Date 09 / 02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/2019"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot. 744, e datës 4.2.2026, për qasje në dokumente publike nga Fatmir Gashi nga fshati Bratotin, komuna e Rahovecit dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, respektivisht procesverbalin e komisionit komunal të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me nr. prot. 744, e datës 4.2.2026, për qasje në dokumente publike nga Fatmir Gashi nga fshati Bratotin, komuna e Rahovecit.

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike si në dispozitiv të këtij vendimi, respektivisht procesverbalin dhe dokumentacionin përcjellës të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësia natyrore (vërshimet e shiut) të muajit janar 2026.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë fizike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.


Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashit, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,**
- **Fatmir Gashit nga Bratotini, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe kërkesës së znj. Jetmira Rakaj – Sylejmanaj, me nr. prot. 800, të datës 9.2.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e zonjës Jetmire Rakaj - Sylejmanaj nga fshati Gur i Kuq (Petkoviq), e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: “Mësimdhënëse në ShFMU ‘31 Marsi” në Petkoviq, nga data 9.2.2026 deri më 31.8.2026.
2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit, që ta largojë nga lista e pagës zyrtaren e lartpërmendur për periudhën e lartcekur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Jetmira Rakaj - Sylejmanaj nga fshati Gur i Kuq (Petkoviq) i komunës së Rahovecit, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës “Mësimdhënëse në ShFMU ‘31 Marsi” në Gur të Kuq (Petkoviq), ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 800, të datës 9.2.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej datës 9.1.2026 deri më 31.08.2026.

Kërkesën, e lartpërmendura, e ka parashtruar për arsye personale, respektivisht sëmundjes me të cilën ajo përballlet dhe e ka të domosdoshme të pushojë në bazë të raportit mjekësor.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë për arsye personale.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- ***Jetmira Rakaj - Sylejmanaj,***
- ***Drejtorja për Arsim,***
- ***Drejtorja për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari/ja për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVCIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6936 Nr. i faq./Br.str./No.pg 02
Data/Datum/Date 10 / 02 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr. 03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Bahrije Çmega** nga Rahoveci, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare e Pranimit, në Drejtorinë për Administratë, i miratohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajsh sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë, nga data 9.2.2026 deri më 9.8.2026. 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 10.8.2026 deri më 10.11.2026, ndërsa, 3 muajt e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset **Drejtoria për Financa dhe Buxhet**.

A r s y e t i m

Punonjësja **Bahrije Çmega** nga Rahoveci, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare e Pranimit, në Drejtorinë për Administratë, nga data 9.2.2026 do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr. 154 të spitalit regional të Gjakovës "Isa Grezda".

Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizojë pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit. Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Nëpunësja ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Bahrije Çmega,**
- **Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Dosjes së punëtores, dhe**
- **Njesisë së Personelit.**

Smajl Latifi
[Signature]
Kryetar i Komunës

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVCIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PRESIDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6397 Nr. i faq./Br.str./No.pg 02

Data/Datum/Date 10 /02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008”), dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, nenit 10 paragrafi 2 i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21, të datës 28.5.2021, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës

1. **Formohet** komisioni për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, në kuadër Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në këtë përbërje:
 - 1.1. Arsim Kastrati, kryesues,
 - 1.2. Jeton Krasniqi, anëtar,
 - 1.3. Veton Kabashi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga parashtrimi i kërkesës, të bëjë shqyrtimin e saj, të konstatojë gjendjen faktike në terren dhe në fund të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë palën përfituese në bazë të kërkesave të parashtruara.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21, të datës 28.5.2021.
4. Mandati i komisionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë 1 (një) vjet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 699 Nr. i faq/Br.str/No.pg 02
Data/Datum/Date 11 / 02 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1 pika 1.6 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për mbulimin e shpenzimeve financiare

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci, me nr. protokolli 633, të datës 23.1.2026, për ndihmë financiare prej 1,000.00€ (një mijë euro) për mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në gara ndërkombëtare të novatorëve.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] dhe [redacted] nga Rahoveci, janë të ftuar që të marrin pjesë si finalistë në finalen ndërkombëtare të novatorëve / hulumtuesve të rinj "iWISE", e cila do të mbahet në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe, nga data 14.2.2026 deri më 16.2.2026.

Andaj, duke marrë parasysh se të lartpërmendurit do të marrin pjesë në këtë garë ndërkombëtare të rinjve, është i domosdoshëm mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe të akomodimit për pjesëmarrjen e tyre nga ana e komunës së Rahovecit.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7002 Nr. i faq./Br.str./No.pg 03

Data/Datumi/Date 12.02.26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Sipas Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, dhe neni 33, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, 1.10 si dhe paragrafi 4 dhe 6 si në dispozitiv të Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në vendimin e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Nr. 271, të datës 14.7.2014, për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e znj. [REDACTED], me nr. të letërnjoftimit [REDACTED], e riatdhesuar nga Gjermania me familjen 4-anëtarshë, e kthyer më datë 15.1.2026 me dhunë, e paraqitur në ZKKK më 21.1.2026, për mbështetje nga masat emergjente të riintegrit, për akomodim për 12 muaj, për herë të parë, nga data 21.1.2026 deri më 20.1.2027, në vlerën prej 330 euro për çdo muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale, sipas kërkesës me nr. 590, të datës 20.1.2026, të parashtruar në ZKKK, në Komunën e Rahovecit dhe sipas ofertës më të lirë.
2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është familja (4) - anëtarshë nga komuna e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 11.2.2026, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar më datë 20.1.2026, nga e riatdhesuara [REDACTED] nga komuna e Rahovecit, për mbështetje nga masat emergjente të riintegrit, për akomodim me qira, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim si dhe anamnezës sociale nga QPS-ja.

[REDACTED] me familjen 4-anëtarshë, ka qëndruar në Tokbahqe nga data 14.1.2026 deri më 20.1.2026 kur është akomoduar në komunën e Prizrenit, për shkak të rrethanave specifike familjare.

Familja po përballlet me një situatë të rëndë socio-ekonomike, e cila bën pjesë në kategorinë e grupeve të cënushme – nënë vetushqyese, gjithashtu, ka një fëmijë me gjendje të rënduar shëndetësore.

Sipas Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, dhe neni 33, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, 1.10 si dhe paragrafi 4 dhe 6, komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe, sipas dëshmive të paraqitura, konstaton që e riatdhesuara i plotëson kriteret për

mbështetje nga masat emergjente të Riintegritimit, për akomodim me qira, të përcaktuara me Rregulloren QRK nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqesë ankesë në Komisionin e Ankesave.

Kopja e vendimit u dërgohet:

1. Të riatdhesuarë [REDACTED]
2. Koordinatorit rajonal të MPB-së,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete,
4. Arkivit të Komunës.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I PRESIDENTIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7003 Nr. i faq./Br.str./No.pg 03

Data/Datum/Date 12 / 02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008”), dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, nenit 10 paragrafi 2 i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21, të datës 28.5.2021, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës

1. **Formohet** komisioni për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, në kuadër Drejtorisë për Shërbime Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1. Venhar Topalli, kryesues,
 - 1.2. Fadil Bugari, anëtar,
 - 1.3. Bjondina Ramaj, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga parashtrimi i kërkesës, të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në terren dhe në fund të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë palën përfituese në bazë të kërkesave të parashtruara.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vjet të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21, të datës 28.5.2021.
4. Mandati i komisionit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është 1 (një) vjet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nëseja Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7005 Nr. i faq/Br.str/No.pg 03

Data/Datum/Date 12 /02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr. 03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Antigona Krasniqi** nga fshati Brrut, komuna e Dragashit, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Arsimin Parashkollor, në Drejtorinë për Arsim, i miratohet pushimi i lehonisë, në kohëzgjatje prej 12 muajsh, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë, nga data 3.2.2026 deri më 3.8.2026. 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 4.8.2026 deri më 4.11.2026, ndërsa, 3 muajt e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset **Drejtoria për Financa dhe Buxhet**.

A r s y e t i m

Punonjësja **Antigona Krasniqi** nga fshati Brrut, Komuna e Dragashit, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Arsimin Parashkollor, në Drejtorinë për Arsim, nga data 3.2.2026, do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr. 1475 të Spitalit Regjional të Prizrenit "Prim. Dr. Daut Mustafa".

Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizojë pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Nëpunësja ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Antigona Krasniqi,**
- **Drejtorisë për Arsim,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Dosjes së punëtores, dhe**
- **Njësisë së Personelit.**

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Prešednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7009 Nr. i faq./Br.str./No.pg 03
Data/Datum/Date 16 / 02 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e aseteve kapitale dhe jokapitale jashtë përdorimit

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e aseteve kapitale dhe jokapitale jashtë përdorimit në Komunën e Rahovecit, në përbërje prej:
 - 1.1. Agnesa Ramadani, kryesuese,
 - 1.2. Bekim Krasniqi, anëtar,
 - 1.3. Faik Thaqi, anëtar.
2. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 31.12.2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Prešednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVIS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7010 Nr. i faq./Br.str/No.pg 03
Data/Datumi/Date 16 / 02 / 26
RAHOVEC / OR. HOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për asgjësimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale

1. **Caktohet** komisioni për asgjësimin e pasurisë kapitale dhe jokapitale në Komunën e Rahovecit, në përbërje prej:
 - 1.1. Luan Sharku, kryesues,
 - 1.2. Tefik Krasniqi, anëtar,
 - 1.3. Luan Danuza, anëtar.
2. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 31.12.2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7013 Nr. i faq./Br.str./No.pg 04

Data/Datum/Date 18 / 02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017 dhe kërkesës së znj. Lindita Ymeri, Menaxhere për Zhvillimin e Kapaciteteve në AKK, të datës 14.1.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Caktohet** grupi i përfaqësuesve nga Komuna e Rahovecit për zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3 – Fuqizimi i Demokracisë Lokale në Kosovë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Zyber Thaqi – Zyrtar për Shpenzime në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa,
 - 1.2. Saranda Shala – Zyrtare për Turizëm në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
2. Grupi i përfaqësuesve i cekur në pinën 1 të këtij vendimi do të marrë pjesë në komisionin vlerësues, komisionin e ankesave dhe komisionin e monitorimit të projekteve të financuara për OJQ-të nga projekti ReLOaD3 – Fuqizimi i Demokracisë Lokale në Kosovë.
3. Grupi i përfaqësuesve ka për obligim që të bashkëpunojë me ekipin e projektit gjatë gjithë fazave të zbatimit të projektit ReLOaD3.
4. Të lartpërmendurit do t'i raportojnë rregullisht Kryetarit të Komunës për të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit,
- Znj. Linditë Ymeri, dhe
- Arkivit.


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PRESEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7016 Nr. i faq./Br.str./No.pg 04

Data/Datum/Date 19 / 02 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Z. [REDAKTUAR] nga fshati Zatriq, me nr. prot. 883, të datës 16.2.2026, për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Z. [REDAKTUAR] ka nga sëmundja e rëndë, i cili ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të. Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së tij, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Me vendim të njoftohen:

- Z. [REDAKTUAR] nga fshati Zatriq,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr. 03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Hana Troshupa-Lezi** nga Hoça e Vogël, komuna e Rahovecit, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Shërbime Sociale, në Qendrën për Punë sociale, në Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, i miratohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajsh sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë, nga data 10.2.2026 deri më 10.8.2026. 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 11.8.2026 deri më 11.11.2026, ndërsa, 3 muajt e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset **Drejtoria për Financa dhe Buxhet**.

A r s y e t i m

Punonjësja **Hana Troshupa-Lezi** nga Hoça e Vogël, komuna e Rahovecit, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Shërbime Sociale, në Qendrën për Punë sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nga data 10.2.2026 do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr. 1473 të spitalit regional të Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë.

Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizojë pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit. Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Nëpunësja ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Hana Troshupa-Lezi,**
- **Qendrës për Punë Sociale**
- **Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Dosjes së punëtores, dhe**
- **Njësisë së Personelit.**

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i objektit të SHFMU "Hamëz Thaqi" në Xërxë", me numër të kontratës: 623-22-7571-5-1-1/C426, si në vijim:
 - 1.1.N.P.N. "UNIVERS – MI"; "P.M.N." SH.P.K. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Bardhok Jetishi, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2.Muhamet Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxheri i Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblërjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblërjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblërjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3110 i datës 9.12.2022.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Sektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smail Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine



	REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>7030</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>05</u>		
Data/Datum/Date <u>23/02/26</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e këshillit organizues të festivalit tradicional folklorik “Anadrinia jehon” 2026

1. **Caktohet** këshilli organizues i edicionit të 25-të të festivalit tradicional folklorik “Anadrinia jehon” 2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Atdhe Rama, kryesues,
 - 1.2. Muharem Morina, koordinator,
 - 1.3. Blerta Gashi, anëtare,
 - 1.4. Qemajl Krasniqi, anëtar,
 - 1.5. Salih Bytyqi, anëtar,
 - 1.6. Fjolla Duraku, anëtare,
 - 1.7. Muhamet Morina, anëtar,
 - 1.8. Besmire Bytyqi, anëtare,
 - 1.9. Bajram Morina, anëtar,
 - 1.10. Ekrem Bytyqi, anëtar,
 - 1.11. Naim Krasniqi, anëtar,
 - 1.12. Feriz Thaqi, anëtar,
 - 1.13. Fatmir Hoti, anëtar,
 - 1.14. Daut Bytyqi, anëtar,
 - 1.15. Afrim Dina, anëtar.
2. Këshilli ka për detyrë që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet organizative për mbarëvajtjen e festivalit, përfshirë seleksionimin e grupeve artistike pjesëmarrëse në festival, rregullimin e skenës, përzgjedhjen e jurisë profesionale për vlerësim, shpërndarjen e ftesave për pjesëmarrësit, si dhe ndarjen e çmimeve të festivalit në natën finale.
3. Obligohet këshilli që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësiwe për pjesën operative të organizimit të festivalit i takon kryesuesit të këshillit organizues.
5. Këshilli organizues është i obliguar që t’i raportojë Kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të festivalit.

6. Këshilli do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat të arsyeshëm.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e këshillit organizues dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
8. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Anëtarët e këshillit organizues,*
- *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0006906/26, e dt. 24.02.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 24.04.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 18.02.2026 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.



Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7036 Nr. i faq./Br.str./No.pg 06

Data/Datum/Date 25/02/26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së znj. Sevdije Berisha me nr. prot. 774, të datës 5.2.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e znj. [REDACTED] nga fshati Kpuz, komuna e Klinës, me vendbanim në Rahovec, e cila jeton me dy fëmijë të mitur jetimë, për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, respektivisht prej datës 1.2.2026 deri më 31.7.2026, te pronarja [REDACTED] në rrugën Dëshmorët e Pashtrikut, pa nr., në Rahovec.
2. **Pagesa**, në emër të qirasë, do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.
3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.
4. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është zonja Sevdije Berisha, e lindur më 8.7.1967.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimi të kërkesës nga pala, ka konstatuar që bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të mitur e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qira, ku të vetmin burim të të ardhurave i ka nga Skema e Ndihmave Sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.

Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DShMS-së. Duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Znj. [REDACTED]
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7041 Nr. i faq./Br.str./No.pg 07
Data/Datum/Date 27 / 02 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e koordinatorit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Rahovecit

1. Z. Skender Hamza, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Udhëheqës i Sektorit për punë të Kuvendit në Komunën e Rahovecit **CAKTOHET** Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Rahovecit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë të përcaktuara në Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
3. Obligohet koordinatori i caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi që punët ti kryej duke u bazuar në Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi si dhe legjislacionin aktual në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Z. Skender Hamza,
- Anëtarëve të KKSB-së,
- MPB-së, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR